



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 107 Prot.

Lezhë, më 26/1 /2024

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2023

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik në Bashkinë Lezhë përgjatë vitit 2023, është bazuar në parimet e mëposhtme:

- Transparencë gjatë procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik,
- Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese,
- Efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike,
- Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

Procesi i njoftimeve dhe konsultimeve publike është realizuar në zbatim të Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin Publik”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”.

Bashkia Lezhë dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkëpunuar për realizimin e një procesi konsultimi efikas dhe hartimin e një plani vjetor të përbashkët. Në zbatim të Vendimit të Kryetari të Bashkisë me Nr.304, datë 12.05.2023 “Për hartimin e kalendarit të konsultimeve publike në Bashkinë Lezhë, për periudhën Maj-Nëntor 2023” është miratuar kalendarit i konsultimeve publike të cilat janë zhvilluar në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë.

Hartimi i kalendarit është bërë në vijim të parashikimeve për konsultime të përcjellura nga drejtoritë e brendshme të Bashkisë.

Gjatë vitit 2023 janë parashikuar për tu realizuar 6 konsultime publike dhe gjithashtu janë realizuar 6 konsultime me banorë në qytetin e Lezhës dhe njësitë administrative përkatëse.

Të gjitha dëgjesat/konsultimet publike janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Lezhë lezha.gov.al, në këndin “Transparenca”, seksioni “Konsultime publike” dhe “Programi i Transparencës.

Ky raport vjetor është hartuar në zbatim të detyrimeve që cakton për autoritetin publik neni 20, i Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. *Sipas parashikimeve të këtij neni, organet publike hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion per:*

- numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit;
- numrin e takimeve publike të organizuara.



➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2023.**

Këshilli Bashkiak Lezhë ka miratuar në total 126 vendime gjatë vitit 2023¹, të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, përkatësisht në këndin “Këshilli Bashkiak”.

➤ **Numri i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ në lidhje me projekt buxhetin afatmesem 2024-2026, buxhetin vjetor si dhe Paketën Fiskale 2024 u regjistruan gjithsej 18 rekomandime konkrete.

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:**

Në lidhje me konsultimin publik për “Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor” nga 11 pyetje/rekomandime 8 prej tyre nuk kanë lidhje konkrete me objektin e rishikimit.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

1. Datë 03.04.2023 / Njoftim Publik për organizimin e dëgjësës publike për Rishikimin e e Planit të Përgjithshëm Vendor

Bashkia Lezhë ka publikuar më datë 03.04.2023 (data e njoftimit zyrtar në faqen e internetit) njoftimin për organizimin e dëgjësës publike në lidhje rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe Vendimin Nr. 201 datë 31.03.2023 “Për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të PPV, Bashkia Lezhë me procedurë të thjeshtuar”. Kjo dëgjësë publike u inicua nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban. Njoftimi është i publikuar në linkun: <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-rishikimin-e-planit-te-pergjithshem-vendor-bashkia-lezhe/> ndërsa dokumentat e tjera shoqërues gjenden në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-rishikimin-e-planit-te-pergjithshem-vendor/> Takimi zgjati rreth 1 orë dhe morën pjesë 25 persona.

❖ **Datë 12.05.2023/ Konsultim me publikun i Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2024-2026.**

Bazuar në Vendimin Nr.304, datë 12.05.2023 “Për hartimin e kalendarit të konsultimeve publike në Bashkinë Lezhë, për periudhën Maj-Nëntor 2023” u hartua kalendari i konsultimeve publike për PBA-në 2024-2026 si dhe buxhetin vjetor. Njoftimi është publikuar në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-zhvillimin-e-konsultimeve-publike-per-pba-2024-2026-buxhetin-vjetor-ne-bashkine-lezhe/> dhe ishin parashikuar 3 takime sipas njesive administrative.

❖ **Maj 2023/ Konsultim publik për Ngritjen e Qendrës Rezidente për grupet vulnerabël.**

Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social gjatë muajit Maj 2023 kishte parashikuar Ngritjen e Qendrës Rezidente për grupet vulnerabël por konsultimi nuk është realizuar sepse në bazë të marrëveshjes që ka Bashkia Lezhë me UNDP dhe PNUD gjatë 3-vjeçarit të parë të funksionimit të kësaj qendre ajo do të menaxhohet nga organizatat dhe jo nga Bashkia si

¹ Vendimet e Bashkisë Lezhë për Vitin 2023: <https://lezha.gov.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-2023/>



institucion. Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social ka qenë pjesë e procesit të hartimit të nevojave që ka komuniteti lezhjan por procesi është udhëhequr nga ata në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për ngritjen e shërbimeve që do të ketë qendra.

2. Datë 11.07.2023/ Këshilli i Bashkisë Lezhë zhvilloi takim konsultues për “Amendim të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak.

Njoftimi për zhvillimin e takimit konsultues është publikuar në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-konsultim-publik-2/> së bashku me projekt-vendimin për ndryshimin e rregullores si dhe procesverbalin e takimit i mbajtur nga Sekretarja e Këshillit Bashkiak. Rregullorja e re parashikon ndryshime në nenet 7, 15, 28, 31, 33, 34, 175.

3. Datë 16.08.2023/ Këshilli i Bashkisë Lezhë thirri takim konsultues për “Miratimin e Rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashkinë Lezhë”

Njoftimi për këtë takim konsultues u publikua në datën 16.08.2023 në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë. Takimi u zhvillua në datën 28.08.2022 në sallën e Bibliotekës “Gjergj Fishta”. Nëpërmjet rregullores së re synohet adresimi i sfidave të pjesëmarrjes, prezantimin e mekanizmave dhe përcaktimi i procedurave që u mundësojnë qytetarëve dhe grupeve të interesit një pjesëmarrje aktive në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nëpërmjet strukturave komunitare. Njoftimin për zhvillimin e konsultimit publik së bashku me dokumentacionin shoqërues gjendet në linkun: <https://lezha.gov.al/njoftim-per-konsultim-publik-3/>

4. Datë 27.09.2022/ Konsultim për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore në Njesinë Administrative Ungrej.

Ky konsultim publik u iniciua nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve të cilët në relacionin shoqërues vlerësojnë si të rëndësishme mundësinë e shfrytëzimit të aseteve pyje dhe kullota me fokus zhvillimin e biznesit dhe kompanive të ndryshme. Sipas studimit të realizuar nga Njesia e Administrimit të Pyjeve kjo sipërfaqe plotëson gjitha kriteret për vendosjen e paneleve diellore si një sipërmarrje e parashikuar në legjislacionin në fuqi. Në takim janë ftuar të marrin pjesë banorë, aktor lokal dhe grupe të ndryshme interesi të zonës. Në faqen zyrtare gjenden të publikuara njoftimi për zhvillimin e konsultimit, relacioni, projekt-vendimi, raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, plani i rievimit dhe procesverbali i takimit.

5. Datë 29.09.2023/ INFO DAY “Hapja e thirrjes së V-të të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin perëndimor (ReLoad)”

Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, komunikimit dhe Transparencës me datë 29.09.2023 publikoi njoftimin zyrtar në faqen zyrtare në internet për organizimin e takimit të sipërcituar. Takimi u zhvillua në datën 12.10.2023, në orën 10:00, pranë Qendrës Kulturore të fëmijëve. Takimi u mbajt nga Elson Frroku, Drejtor i Drejtorisë së



Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës dhe morën pjesë përfaqësues të OSHC-ve lokale dhe jo vetëm. Gjatë takimit u prezantuan prioritetet të cilat janë si më poshtë:

- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Lezhës;
- Cilësia e jetës dhe komunitetit;
- Zhvillim i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit;
- Zhvillimi i aftësive kompjuterike dhe sistemeve të informatizuara (TIK).

6. Datë 02.10.2022 / Konsultim Publik për PBA 2024-2026, Buxheti vjetor 2024 si dhe Paketën Fiskale 2024

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, u hartua kalendari i konsultimeve publike për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetin vjetor 2024, si dhe Taksat e Tarifat Vendore (Paketa Fiskale 2024), për të gjitha njësitë administrative në Bashkinë Lezhë. Sipas Urdhërit Nr.366 datë 02.10.2023 “Për miratimin e kalendarit të konsultimeve publike për PBA-në 2024-2026, buxhetin vjetor si dhe për Taksat e Tarifat Vendore” u përcaktua zhvillimi i 3 takimeve konsultative përkatësisht:

17 Tetor 2023 – Bashkia Lezhë zhvilloi dëgjese publike në kuadër të hartimit të Buxhetit 2024, PBA 2024-2026 dhe Paketës Fiskale me banorë të njësive administrative Balldre, Dajç, Blinisht, Kallmet dhe Ungrej, pranë ambientit Bar Restorant “Suli” në autostradë, me prezencën e panelit prej nëntë anëtarësh; Kryetari i Bashkisë Z.Pjerin Ndreu, Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Ermal Pacaj, Zv.Kryetarja e Bashkisë Znj.Eueda Molla, Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Ndue Luli, Administratori i njësisë administrative Balldre Z.Redon Gjelogji, Administratori i njësisë administrative Kallmet Z.Eraldo Marku, Administratori i njësisë administrative Dajç Z.Paulin Gazulli, Administratori i njësisë administrative Ungrej Z.Agustin Zefi si dhe Administratori i njësisë administrative Blinisht Z.Pjetër Gjini. Problemet kryesore që qytetarët paraqitën në këtë konsultim ishin pastrimi i kanaleve në fshatin Dragushë, rruga në zonën e Mabës, furnizimi me ujë të pijshëm në zonën e Kakarriqit, pastrimi i ferrave nga autostrada deri në varrezat e Blinishtit, etj. Takimi zgjati rreth 70 minuta dhe morën pjesë 100 persona. Procesverbali i takimit gjendet në linkun <https://lezha.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Procesverbal-17.10.2023.pdf>

18 Tetor 2023 – Bashkia Lezhë zhvilloi konsultimin publik mbi hartimin e buxhetit vjetor 2024 dhe Paketës Fiskale 2024 me banorë të njësive administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh, pranë ambienteve të Restorant “Orkidea” në orën 17:00. Takimi u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Lezhë Z.Pjerin Ndreu. Pjesë e panelit ishin gjithashtu Zv.Kryetarja e Bashkisë Znj.Eueda Molla, Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Ermal Pacaj, Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Ndue Luli, Administratori i Njësisë Administrative Shënkoll Z.Ernest Rakaj, Administratori i njësisë Administrative Zejmen Z.Leonard Perjaku dhe Administratori i njësisë administrative Kolsh Z.Fatjon Zefi. Disa nga problematikat e evidentuara ose rekomandimet e sygjera kanë të



bëjnë me detyrimin e pagimit të taksave nga familjarët njësoj si dhe bizneset, zgjerimi i varrezave të Zejmenit, ujësjellësi i fshatit Tresh, pastrimi i kanaleve kulluese në Tale, Barbullojë e Re, problematika me rrugë të lagjeve nëpër njesi administrative, etj. Takimi zgjati rreth 70 minuta dhe morën pjesë 91 persona. Procesverbali i takimit gjendet në linkun <https://lezha.gov.al/ep-content/uploads/2023/11/Procesverbal-18.10.2023.pdf>

19 Nëntor 2023 – Bashkia Lezhë zhvilloi konsultimin e fundit publik në kuadër të hartimit të buxhetit 2024, PBA 2024-2026 dhe Paketës Fiskale 2024 me banorë të njësive administrative Shëngjin dhe Lezhë. Takimi u mbajt pranë ambienteve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Gjergj Lacaj” me prezencën e Kryetarit të Bashkisë z.Pjerin Ndreu, zv.Kryetares së Bashkisë Znj.Eueda Molla, Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Ermal Pacaj, Kryetarit të Këshillit Bashkiak z.Ndue Luli, dhe Administratori i njësive administrative Shëngjin Z.Brahim Demi. Disa nga problematikat e evidentuara kanë të bëjnë me ndryshimin e nivelit të taksave të njëjta në vite të ndryshme, cilësia e shërbimeve, demokracia lokale, infrastruktura për të verbërit, ndarja e kanaleve të ujrave të bardha e të zeza, varrezat e qytetit, etj. Takimi zgjati rreth 80 minuta dhe morën pjesë 110 persona, banorë nga komuniteti, përfaqësues nga OJF, media lokale, grupe vulneraël etj. Procesverbali i takimit gjendet në linkun <https://lezha.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Procesverbal-19.10.2023.pdf>

❖ **Datë 16.11.2023/ Konsultim për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore në Njesitë Administrative Kolsh dhe Zejmen.**

Ky konsultim publik u iniciua nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, njoftimi për të cilin u publikua me datë 16.11.2023 së bashku me dokumentacionin shoqërues (relacioni, projekt-vendimi, raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, plani i rilevimit). Në ditët në vijim Drejtoria përgjegjëse njoftoi për anulimin e kësaj dëgjese dhe zhvillimin e saj në një moment të dytë. Njoftimin për anulimin e dëgjësës gjendet në linkun: <https://lezha.gov.al/njoftim-per-anullimin-e-degjeses-publike/>

DREJTORI

Elson Frroku

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
Gjystina Nik-ulaj